



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“FERMA BUJQËSORE DHE BLEGTORALE”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

H2-III-19

Tiranë më, Maj 2019

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

| Emërtimi i kualifikimit | “Ferma bujqësore dhe blegtorale” | | | Kodi |
|--|---|---------------|---|------------------|
| Kohëzgjatja | 900-1100 orë | Niveli | III në KSHK, referuar nivelit III të KEK | H2-III-19 |
| Qëllimi: | Qëllimi i kualifikimit profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me bujqësinë dhe mbarështimin e blegtorisë; | | | |
| Kriteret e përgjithshme të pranimit: | <p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Ferma bujqësore dhe blegtorale” të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar kualifikimin profesional “Bujqësi”, nivelin II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; - janë në gjendje shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; - kanë aftësi të kufizuara, për të cilët institucionet përgjegjëse krijojnë kushte dhe përshtatin programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin. | | | |
| Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit: | <p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të nivelit të punonjësit të kualifikuar në tregun punës.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në fermat bujqësore në: prodhimin bujqësor të bimëve të arave në sektorin shtetëror ose privat; mbrojtjen e bimëve në sektorin shtetëror ose privat; njësitë përpunuese të prodhimit të bimëve të arave dhe perimeve; në fermat që mbarështojnë: gjedh për prodhim qumështi dhe mishi, të imta (të leshta dhe të dhirta), derra, shpendë, në njësi apo veprimtari të tjera që aktiviteti i tyre lidhet me mbarështimin e kafshëve të fermës apo të vetëpunësohet në drejtimet e sipërpërmendura në fermën e vogël familjare.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesëm dhe universitare.</p> | | | |
| Data e validimit | | | | |
| Data e miratimit | | | | |
| Variantet e mëparshme | H-II-02-14 | | | |

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

BUJQËSIA

Të përgjithshme

- Të përshkruajë prodhimin bujqësor si furnizuesin kryesor të prodhimit blegtoral dhe anasjelltas;
- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike të aktivitetit bujqësor e blegtoral në ekonominë e vendit dhe në nivel ferme;
- Të përshkruajë legjislacionin në fuqi për tokën dhe aktivitetin bujqësor e përpunues,
- Të dallojë hartat kadastrale të ngastrave të tokave bujqësore që duhet të përdoren në fermë dhe qëllimet e tyre;

Mënyrat e punimit të tokës

- Të rendisë sistemet kryesore të punimit të tokës;
- Të shpjegojë sistemin e punimit të tokës sipas relievit dhe tipit të tokës;
- Të përshkruajë veçoritë e sistemit të punimit të tokës për kulturat e vjeshtës në varësi të parabimës;
- Të shpjegojë veçoritë e sistemit të punimit të tokës për kulturat pranverore;
- Të shpjegojë veçoritë e sistemit të punimit të tokës për kulturat e dyta sipas tipit të tokës;
- Të rendisë veçoritë e punimit në tokat e reja;
- Të argumentojë hapat teknologjikë të procesit të plugimit të tokës;
- Të shpjegojë llojet e punimeve plotësuese(sipërfaqësore) të tokës;
- Të shpjegojë veçoritë dhe funksionin e punës së diskut në punimet përgatitore të tokës;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e lesave në punimet përgatitore të tokës;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e kultivatorëve në punimet përgatitore të tokës;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e branave në punimet përgatitore të tokës;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e rulave në punimet përgatitore të tokës;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e kombinatorëve në punimet përgatitore të tokës;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e frezave me veprim aktiv për punime përgatitore të tokës;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e lesave dridhëse me veprim aktiv në punimet përgatitore të tokës;

Përdorimi i makinave Bujqësore

- Të shpjegojë mënyrat e shpërndarjes së plehrave(organike, organike të lëngëta dhe kimike) me mjete të mekanizuara;

- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e makinave mbjellëse me rreshta në kulturat që mbillen me dendësi të madhe;
- Të shpjegojë mbjelljen me rreshta në drithërat e lashta (grurë, elb, thekër, tërshërën) me makinë universale të mbjelljes;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e makinave mbjellëse me saktësi në kulturat që mbillen me rreshta të gjerë;
- Të shpjegojë mbjelljen e drithërave të vona(misër) me makinë mbjellëse me precizion;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e makinave mbjellëse të patates;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e makinave që përdoren për mbjelljen e fidanëve të kulturave perimore dhe në bimët e arave;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe përdorimin e makinave prashitëse(kultivatorë, freza) të kulturave bujqësore;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe përdorimin e makinave spërkatëse për mbrojtjen e bimëve;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe përdorimin e makinave kositëse të kulturave foragjere;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe përdorimi i makinave për hapjen, kthimin dhe mbledhjen e barit;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionon e makinave korrëse, shirëse dhe përpunuese të drithërave;
- Të shpjegojë veçoritë, llojet dhe funksionin e makinave për hapjen e rrjetit kullues dhe ujitës;

Ujitja, kullimi dhe mbrojtja nga përmytjet e tokës

- Të rendisë faktorët më të rëndësishëm për zgjedhjen e mënyrave të ujitjes;
- Të shpjegojë mënyrat e ujitjes dhe hapat teknologjike të realizimit të tyre sipas llojit të kulturës dhe sistemit të tokës;
- Të përshkruajë mënyrat e ujitjes sipërfaqësore(brazda, rrëshqitje, rripa, shpore, përmytje.);
- Të rendisë përparësitë e ujitjes me pika dhe shi hedhje;
- Të shpjegojë mënyrat e ujitjes me pika dhe shi hedhje, si dhe kulturat ku përdoren;
- Të përshkruajë faktorët që përcaktojnë nevojat për kullim në tokat me tepriçë ujore;
- Të përshkruajë sistemin e kanaleve kulluese në rrjetin e kullimit;
- Të shpjegojë skemat e rrjetit të kanaleve kulluese (K1K, K2K, K3K) dhe rolin e tyre në kullimin e ngastrës së tokës;
- Të shpjegojë drenazhimin si proces kullimi;
- Të përshkruajë llojet e drenave (të përkohshme dhe përhershme) si dhe dallimet midis tyre;

Agroteknologjia e prodhimit bimor

- Të përshkruajë karakteristikat e kultivarëve të të lashtave (grurë, elb, tërshërë, thekër etj.);
- Të përshkruajë veçoritë e kultivimit të të lashtave sipas zonave klimatiko-tokësore të vendin tonë, nga momenti i përgatitjes së tokës, mbjelljes, shërbimeve, korrjes dhe përpunimit, transportit e magazinimit të prodhimit të të lashtave;
- Të përshkruajë llojet e hibrideve të misrit që përdoren në vendin tonë, si dhe karakteristikat e tyre;

- Të përshkruajë veçoritë e kultivimit të misrit sipas zonave klimatiko – tokësore;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e kultivimit të misrit hamullor si kulturë me vete dhe të bashkëshoqëruar;
- Të shpjegojë arsyet e bashkëshoqërimit dhe veçoritë e kultivimit të dy kulturave së bashku;
- Të shpjegojë specifikat e kultivimit të orizit që nga zgjedhja e tokës, ndërtimi i orizoreve , mbjellja e fidanëve, shërbimet kulturore e deri në vjeljen e prodhimit e magazinimin;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e kultivimit e fasules për kokërr;
- Të shpjegojë mënyrën e kultivimit të fasules së bashkëshoqëruar sipas zonave klimatiko- tokësore të vendit tonë;
- Të shpjegojë veçoritë e kultivimit të sojës si bime bishtajore për kokërr dhe ndryshimet e agroteknologjisë së saj me fasulen;
- Të shpjegojë veçoritë e agroteknologjisë së kultivimit të qiqrës, thjerrëzës, bathës për kokërr (përgatitja e tokës, mbjellja, shërbimet, vjeljen dhe magazinimin e prodhimi);
- Të shpjegojë veçoritë e agroteknologjisë e kultivimit të pambukut;
- Të shpjegojë veçoritë në agroteknologjinë e kultivimit të panxhar sheqerit;
- Të përshkruajë veçoritë e kultivimit të lule diellit si bime e rëndësishme për prodhim vaji;
- Të rendisë shërbimet më specifike të lulediellit për prodhim vaji;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e kultivimit të kikirikut për prodhim vaji;
- Të përshkruajë kultivarët kryesore dhe hibridet e duhanit që mbillen në vendin tonë sipas zonave të kultivimit;
- Të përshkruajë treguesit që përcaktojnë cilësinë e gjetheve të duhanit;
- Të përshkruajë përgatitjen e fidanëve të duhanit në farishte;
- Të përshkruajë mbjelljen e fidanit në fushë të hapur dhe shërbimet specifike të tij;
- Të përshkruajë vjelje dhe grumbullimin gjetheve të duhanit,
- Të përshkruajë mënyrat e tharjes dhe të manipulimit të duhanit;
- Të përshkruajë kultivarët e patates në vendin tonë dhe veçoritë e kultivimit të saj sipas zonave;
- Të përshkruajë procesin e përgatitjes së materialit mbjellës(zhardhokut) për bulëzim;
- Të përshkruajë mënyrat e mbjelljes së patates, shërbimet deri në procesin e vjeljes;
- Të shpjegojë mënyrat e ruajtjes së zhardhokëve të patates dhe përparësitë e mangësitë e secilës mënyrë;
- Të përshkruajë bimët aromatike kryesore që përdoren në farmaceutikë, mjekësi dhe erëza;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore sipas zonave (sherbelë, lavanda, rozmarina, kamomili, trumzë, borziloku etj.);
- Të shpjegojë agroteknologjinë e kultivimit eterovajore;
- Të përshkruajë veçoritë e rritjes së kulturave foragjere sipas grupimit të prodhimit foragjer;
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të kulturave foragjere kryesore gramore një vjeçare (gruri foragjerë, thekër, tërshërë, elb, misër, melekuqe) sipas përdorimit të;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e kultivimit të bimëve gramore shumëvjeçare (egjër, telishi, bishtmiu, bishtdhelper, flokëza livadhore, bromust etj.) sipas përhapjes së zonave në vendin tonë;

- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të kulturave kryesore foragjere bishtajore një vjeçare (bathë, bizele, buxhaku, urovi, koçkull, sojë lupin i ëmbël etj.) për prodhim kokrrë dhe njomishte;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e kultivimit të tërfillit Aleksandrin, si dhe përparësitë ndaj kulturave të tjera foragjere bishtajore për njomishte;
- Të shpjegojë agroteknologjinë e kultivimit të jonxhës si bimë bishtajore shumë vjeçare për prodhim mase të gjelbër dhe bar të thatë;
- Të përshkruajë mënyrat e tharjes së jonxhës dhe ruajtjes së saj për bar të thatë;
- Të shpjegojë konceptin e bashkëshoqërimit dhe bashkërendimit të prodhimit foragjer;
- Të shpjegojë rajonizimit dhe strukturës së mbjelljes së kulturave foragjere, sipas përhapjes zonale;
- Të rendisë disa skema të thjeshta të konvejerit të gjelbër foragjer, sipas zonave klimatik të vendi (fushore, kodrinore dhe malore);
- Të krahasojë veçoritë e kultivimit të kulturave perimore për prodhim fruti, gjethe, frutrrënjor, lule, bishtajë etj., sipas grup familjeve;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e prodhimit të hershëm të perimeve solanore (domate, spec, patëllxhan);
- Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së fidanëve për prodhim të hershëm (domate, spec, patëllxhan);
- Të shpjegojë mbjelljen e fidanëve në fushë të perimeve solanore (domate, spec, patëllxhan);
- Të shpjegojë agroteknikën e mbjelljes për prodhim të mesëm e të vonët të perimeve solanore;
- Të shpjegojë prodhimin e perimeve solanore (domate, spec, patëllxhan) në mjedise të mbrojtura;
- Të shpjegojë mënyrat e ruajtjes së prodhimit të perimeve solanore në depo e magazina;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e prodhimit të qepës me qepujka;
- Të përshkruajë prodhimin e qepës së thatë me fidanë e farë;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e prodhimit të qepës së njomë me qepujka dhe fidanë;
- Të përshkruajë veçoritë e kultivimit të qepës për farë;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e prodhimit të preshit me fidanë, si dhe specifikat e prodhimit, vjeljes e magazinimit;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e prodhimit të hudhrës me thelpinj, si dhe specifikat e prodhimit, vjeljes dhe magazinimit;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e prodhimit të(kastravecit, pjeprit, shalqinit, kungullit) në mjediset e mbrojtura;
- Të shpjegojë veçoritë e agroteknologjisë së kultivimit të perimeve bostanore (kastravec, shalqi, pjepër, kungull) në fushë;
- Të shpjegojë specifikat e agroteknologjisë së prodhimit të lakrës, lulëlakrës me fidanë;
- Të përshkruajë përgatitjen e fidanëve lakrës dhe lulëlakrës, mbjelljen në fushë shërbimet, vjeljen, transportin, grumbullimin seleksionimin dhe ruajtjen e prodhimit;
- Të shpjegojë agroteknologjinë e prodhimit të perimeve frut-rrënjorë(rrepës dhe rilkës) me farë;
- Të shpjegojë agroteknologjinë e prodhimit të spinaqit, pazisë, lëpjetës për prodhim gjethor;

- Të shpjegojë agroteknologjinë e prodhimit të panxharit të kuq me farë;
- Të shpjegojë agroteknologjinë e prodhimit të sallatës me farë dhe fidanë;
- Të shpjegojë hapat agroteknologjikë prodhimit gjethor të sallatës;
- Të shpjegojë veçoritë e agroteknologjinë e kultivimit të çikores dhe angjinares;
- Të shpjegojë specifikat e agroteknologjisë së kultivimit të karotës me farë;
- Të shpjegojë agroteknologjinë e kultivimit të perimeve të vogla për erëza (selino, majdanoz, kopër,) në përputhje me kërkesat specifike të tyre;
- Të shpjegojë agroteknologjinë e kultivimit të bizeles dhe bathës në fushë;
- Të shpjegojë agroteknologjinë e kultivimit të bamjes në fushë;
- Të përshkruajë mënyrat e ruajtjes së perimeve në gjendje të ngrirë;
- Të përshkruajë procesin teknologjik të ngrirjes së perimeve (kontrolli i lëndës së parë, larja, pastrimi, përvëlimi, ftohja , ambalazhimi dhe ruajtja e perimeve të ngrira);
- Të rendisë disa nga perimet, që ruhen në ngrirje;
- Të shpjegojë mënyrat e ç’ ngrirjes së perimeve (me ajër, me kontakt jo drejtpërdrejt me ujin dhe me kontakt drejtpërdrejt me ujin);
- Të përshkruajë materialet që përdoren për ambalazhimin e produkteve që ruhen në frigorifer;
- Të shpjegojë vargëzimin e prodhimit të perimeve gjatë gjithë vitit, sipas zonave klimatiko-tokësore në vendin tonë;

Prodhimi i farës

- Të shpjegojë rolin e prodhimit të farës për material mbjellës në fermën bujqësore;
- Të shpjegojë legjislacionin dhe rregullat e veçanta që zbatohen për prodhimin e farës;
- Të shpjegojë elementet përbërës që përcaktojnë cilësinë e farës (pastërtia mekanike e gjenetike, aftësia, fuqia dhe energjia mbirëse);
- Të shpjegojë materialet e shtimit me farë e materiale të shumëzimit vegjetativ që përdoren për mbjelljen dhe kultivimin e bimëve bujqësore sipas specieve dhe veçori për kultivarë të caktuar;
- Të shpjegojë veçoritë agroteknike të prodhimit të farës;
- Të shpjegojë kriteret në aprobimin fushor të farës analizat laboratorik edhe standardet shtetërore;
- Të vlerësojë kulturat bujqësore për prodhimtari, qëndrueshmëri ndaj të ftohtit, thatësisë, rrëzimit, si dhe sëmundjeve e dëmtuesve, duke përdorur sistemin e ballëve;
- Të shpjegojë rregullat e ruajtjes së farës, si dhe mënyrat e manipulimit të saj;

Mbrojtja e bimëve

- Të përshkruajë qëllimin, rëndësinë e mbrojtjes së bimëve;
- Të përshkruajë vlerësimin e dëmit ekonomik që shkaktojnë sëmundjet dhe dëmtuesit në bimë;
- Të përshkruajë se si është e organizuar shërbimi i mbrojtjes së bimëve në legjislacionin ekzistues;
- Të përkufizojë sëmundjet e kulturave bujqësore dhe si klasifikohen ato;
- Të listojë faktorët abiotikë dhe biotikë, si shkaktarë të sëmundjeve të ndryshme;
- Të përshkruajë viruset si shkaktarë të sëmundjeve virusale;

- Të përshkruajë biologjinë dhe klasifikimin e bakteve fitopatogjenë, si dhe shenjat e sëmundjeve bakteriale;
- Të përshkruajë kërpudhat, klasifikimin, ciklin jetësor, mënyrat e shumimit, si dhe sëmundjet kërpudhore;
- Të shpjegojë sëmundjen si proces patologjik, fazat, mënyrat e përhapjes, diagnostikimin dhe imunitetin (qëndrueshmërinë) e bimëve ndaj sëmundjeve;
- Të përshkruajë ndërtimin, biologjinë dhe dëmet që shkaktojnë nematodat (krimbat), kërmijtë, etj. si dhe masat e luftimit ndaj tyre;
- Të përshkruajë ndërtimin e kandrave (insekteve), ciklin e zhvillimit të tyre, mënyrat e riprodhimit, metamorfozat dhe dëmet që shkaktojnë në prodhimin bimor;
- Të theksojë rolin e faktorëve ekologjikë në zhvillimin dhe shumimin e parazitëve dhe dëmtuesve;
- Të shpjegojë përhapjen, përshkrimin, shenjat e dëmtimit dhe masat e luftimit ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve polifagë në bimët e arave;

Metodat e luftimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve

- Të analizojë rolin e metodës së vrojtimit prognozë sinjalizimit, si parandaluese të përhapjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të përshkruajë metodat e ndryshme të luftimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve në kulturat bujqësore;
- Të përshkruajë mënyrën e luftimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve me anë të ndërhyrjeve agroteknike, biologjike dhe luftës së integruar;
- Të shpjegojë përparësitë e luftës agroteknike, biologjike dhe integruar ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve;
- Të përshkruajë preparatet kryesore kimike që përdoren sot në bujqësi;
- Të theksojë rregullat e përdorimit të ruajtjes së preparateve kimike, si dhe dhënies së ndihmës së shpejtë në rast rreziku;
- Të shpjegojë pse metoda kimike e luftimit duhet përdorur me kujdes për mbrojtjen e tokës nga ndotjet;
- Të rendisë preparatet kimike që përdoren për luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në kulturat bujqësore (herbicide, fungicide, insekticide);
- Të përshkruajë cilësitë që duhet të kenë pesticidet dhe rregullat e përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të preparateve kimike nga punëtorët e specializuar;
- Të listojë masat për sigurimin e shëndetit të punonjësve dhe ndotjes së mjedisit;
- Të përshkruajë sëmundjet kryesore që prekin bimët e arave, perimeve dhe drufrutorëve, si dhe të përcaktojë masat e luftimit të tyre;
- Të përshkruajë dëmet nga dëmtuesit kryesorë që prekin bimët e arave perimeve dhe drufrutorëve, si dhe të përcaktojë masat e luftimit ndaj tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së preparateve kimike të domosdoshëm në luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;

- Të përshkruajë disa nga dëmtuesit kryesorë të prodhimeve të ruajtura në depo dhe masat efikase të luftimit të tyre;

Përpunimi i prodhimit bimor

- Të theksojë rëndësinë ekonomike të përpunimit e ruajtjes së produkteve bujqësor me origjinë bimore;
- Të përshkruajë cilësitë, klasifikimin, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit e të ruajtjes së produkteve të drithërave;
- Të përshkruajë mënyrat e ambalazhimit, etiketimit të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara;
- Të përshkruajë cilësitë, përbërjen kimike të perimeve që përdoren si lëndë e parë në industrinë e përpunimit;
- Të përshkruajë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të perimeve për salcë, turshi etj.;
- Të përshkruajë mënyrat e ambalazhimit, etiketimit të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të perimeve;
- Të përshkruajë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të frutave (komposto, marmelatë, reçel, frutave të thata etj.);
- Të përshkruajë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të rrushit (raki, verë, rrush i thatë);
- Të përshkruajë mënyrat e ambalazhimit, etiketimit të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të frutave;
- Të përshkruajë cilësitë, përbërjen kimike të bimëve vajore që përdoren si lëndë e parë në industrinë e përpunimit për vaj (ullirit, luledielli etj.);
- Të përshkruajë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të bimëve vajore;
- Të tregojë mënyrat e ambalazhimit, etiketimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të bimëve vajore;
- Të përshkruajë mënyrat e përpunimit të prodhimit foragjer si ushqim për blegtorinë;
- Të përshkruajnë mënyrat e ruajtjes së prodhimit foragjer të përpunuar;

BLEGTORIA

Ushqimet dhe të ushqyerit

- Të përshkruajë përbërjen kimike të ushqimeve dhe koeficientin e tretshmërisë;
- Të përshkruajë teknologjinë e përgatitjes së silazhit dhe senazhit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përgatitjes së ushqimeve të koncentruara;
- Të përshkruajë teknologjinë e përgatitjes së ushqimeve të koncentruara;
- Të përshkruajë etapat e hartimit të një racioni ushqimor;
- Të përshkruajë strukturën e një racioni ushqimor;
- Të shpjegojë normat ushqimore që nevojiten për mirëmbajtje, prodhim dhe riprodhim në kafshë dhe shpendë;
- Të shpjegojë teknikat e përpilimit të një racioni ushqimor për kafshët dhe shpendët;
- Të përshkruajë të ushqyerit e të imëtave sipas kategorive;

- Të hartojë racione ushqimore për gjedhin, të imtat, derrat dhe shpendët sipas kategorive;
- Të hartojë nevojat për energji, proteina, lëndë minerale dhe vitamina në kafshët për mish si: gjedh, derra, dhen, lepuj, etj.;
- Të shpjegojë teknologjinë e të ushqyerit të gjedhit sipas fazave fiziologjike;
- Të përshkruajë të ushqyerit e lopëve barse, në tharje dhe në laktacion;
- Të përshkruajë të ushqyerit e viçave, gicave dhe qengjave sipas grupmoshave;
- Të përshkruajë përllogaritjen e lopëve foragjere, të prodhimit të qumështit dhe përqindjes së yndyrës;
- Të përshkruajë nevojat për lëndë minerale dhe vitamina në shpendët për mish dhe vezë;
- Të përshkruajë mënyrat e shfrytëzimit të kullotës dhe livadhit;

Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve

- Të shpjegojë rëndësinë e mirëqenies së kafshëve dhe shpendëve në fermë;
- Të specifikojë aktet ligjore dhe nënligjore që veprojnë në fushën e mirëqenies së kafshëve;
- Të listojë pesë liritë, mbi bazën e të cilave vlerësohet mirëqenia e kafshëve në çdo sistem blegtoral;
- Të rendisë detyrat e punonjësit të fermës gjatë inspektimit të vendit apo ambientit ku qëndrojnë kafshët;
- Të përshkruajë thelbin dhe natyrën e sëmundjes;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të gjendjes së përgjithshme shëndetësore të kafshëve;
- Të përshkruajë konceptin e profilaksisë kundër sëmundjeve infektive;
- Të shpjegojë llojet e profilaksisë për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme në një fermë blegtorale;
- Të identifikojë burimet e infeksionit të kafshët;
- Të argumentojë masat për profilaksinë e veçantë;
- Të krahasojë karantinën me izolimin;
- Të shpjegojë masat e tjera parandaluese si: kushtet për kafshët e sëmura, personelin e duhur, asgjësimin e kufomave, grumbullimi e përpunimi biotermik i plehut etj.;
- Të listojë mënyrat e asgjësimit të kafshëve, materialeve dhe mbeturinave me djegie;
- Të shpjegojë rëndësinë e masave veterinarë, për mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zoonotike të përbashkëta për njerëz dhe kafshë;

Riprodhimi.

- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e organeve gjinore femërore dhe mashkullore;
- Të përshkruajë ndërtimin anatomik dhe fiziologjik të gjirit, në kafshë të ndryshme;
- Të theksojë rëndësinë praktike të njohjes së reflekseve seksuale në kafshë
- Të tregojë mënyrat e ndërzimit të kafshëve;
- Të përshkruajë ndryshimet anatomike dhe fiziologjike të kafshët barsë;
- Të përshkruajë zgjatjen e mbarsmërisë në kafshë të ndryshme;
- Të tregojë kujdesin për kafshën barsë;

- Të tregojë veçoritë e pjelljes në kafshë të ndryshme, kujdesin dhe ndihmën për kafshën gjatë pjelljes;
- Të përshkruajë dështimet në kafshë;
- Të përshkruajë shenjat klinike të disa patologjive kryesore të organeve gjinore;

Agropërpunimi

- Të përshkruajë cilësitë, përbërjen kimike të qumështit që përdoret si lëndë e parë në industrinë e përpunimit të qumështit;
- Të përshkruajë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të qumështit për konsum të freskët, kos, djathë, gjizë etj.;
- Të tregojë mënyrat e ambalazhimit;
- Të përshkruajë mënyrat e ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të qumështit;
- Të përshkruajë rëndësinë, cilësitë e mishit që përdoret si lëndë e parë në industrinë e përpunimit të mishit;
- Të përshkruajë cilësitë organoleptike të mishit;
- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit të kafshëve dhe të shpendëve para therjes së tyre;
- Të tregojë mjetet, pajisjet dhe mënyrat e therjes së kafshëve e shpendëve;
- Të përshkruajë ndarjen anatomike të mishit të kafshëve dhe shpendëve;
- Të tregojë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të mishit;
- Të shpjegojë përgatitjen e qumështit nga soja e tërshëra;

Trajtimi i mbetjeve

- Të përshkruajë mënyrën e trajtimit të mbetjeve nga përpunimi i mishit;
- Të shpjegojë mënyrën e trajtimit të mbetjeve të lëngshme në një fermë qumështi;
- Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe mirëmbajtjes së makinave mjelëse;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të higjienës personale

Ekonomia në fermën bujqësore e blegtorale

Planifikimi, organizimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore e blegtorale

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes së një aktiviteti bujqësor e blegtoral;
- Të shpjegojë organizimin e punës në një fermë bujqësore e blegtorale;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të përshkruajë karakteristikat e konsumatorëve vendas dhe të huaj;
- Të listojë nevojat sasiore dhe cilësore të konsumatorëve për produktet bujqësore e blegtorale;
- Të shpjegojë procedurat për hapjen e një ferme bujqësore e blegtorale;
- Të identifikojë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në ngritjen e një aktiviteti bujqësor e blegtoral;
- Të shpjegojë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre;
- Të shpjegojë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;

- Të përshkruajë elementet bazë për hartimin e një plani marketingu për prodhimet bujqësore e blegtorale;
- Të shpjegojë rëndësinë e shpërndarjes së produkteve bujqësore e blegtorale;
- Të shpjegojë rëndësinë e hartimit të kontratave të shit-blerjes për produktet bujqësore dhe blegtorale;
- Të shpjegojë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij;
- Të përshkruajë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me aktivitetin bujqësor e blegtoral;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së çmimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të shpjegojë përgatitjen, plotësimin e një faturë blerjeje apo shitje;
- Të përshkruajë nevojën e hartimit të një preventivi për produktet bujqësore e blegtorale;
- Të përshkruajë nocionin e të ardhurave dhe shpenzimeve për fermën bujqësore e blegtorale;
- Të interpretojë dhe plotësojë dokumentacionin financiar për fermën bujqësore e blegtorale;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve me bizneset bujqësore e blegtorale vendase dhe të huaja;
- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike të aktivitetit bujqësor e blegtoral në ekonominë e vendit dhe në nivel ferme;
- Të shpjegojë rëndësinë e krijimit të rrjetit të bashkëpunimit me biznese të suksesshme bujqësore e blegtorale në vend dhe jashtë saj;

Mbledhja dhe shitja e produkteve

- Të listojë kriteret për marketingun e prodhimit në mënyrë korrekte;
- Të përshkruajë përpunimin, manipulimin e produktet në përputhje me kriteret e marketingut;
- Të përshkruajë produktet bujqësore për marketing;
- Të shpjegojë teknikat e paketimit të produkteve të kopshtit të fermës;
- Të identifikojë rregulloret në fuqi për paketimin e prodhimit bujqësore;
- Të përshkruajë pasojat e paketimit të papërshtatshëm;
- Të rendisë pajisjet pakuese të përdorura në përputhje me kriteret e cilësisë;
- Të shpjegojë rreziqet që lidhen me përdorimin e këtyre makinave;
- Të përshkruajë rregullat e etiketimit të produkteve të paketuara i plotëson kërkesat komerciale;
- Të përshkruajë mënyrat e ruajtjes dhe magazinimit të produkteve;
- Të përshkruajë parimet themelore të funksionimit të pajisjeve të ruajtjes (dhomat e ftohta...);
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së produkteve nga rreziku i dëmtimit gjatë transportit dhe operacionit të shitjes në fermë;
- Të përshkruajë mënyrat e kontaktimit me klientët: mirëpritja, dëgjimi dhe këshillimi i konsumatorëve;
- Të shpjegojë rregullat e mirësjelljes me klientin;
- Të përshkruajë rregullat e përdorimit të një komunikimi të përshtatshëm me klientin;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Punimi i tokës

- Të kryejë punimin e tokës me plug sipas relievit dhe tipit të tokës;
- Të kryejë punimin e tokës për kulturat e vjeshtës në varësi të parabimës;
- Të kryejë punimin e tokës për kulturat e pranverore në varësi të parabimës;
- Të kryejë punimin e tokës për kulturat e dyta sipas tipit të tokës;
- Të kryejë punimin e tokave të reja me plug specifik;
- Të vlerësojë cilësinë e procesit të plugimit të tokës sipas treguesve teknik;
- Të kryejë punime plotësuese ose sipërfaqësore të tokës;
- Të realizojë procesin e diskimit të tokës;
- Të kryejë procesin e lesimit të tokës;
- Të kryejë procesin e punimit të tokës me mjete punë aktive (freza, lesa vibruese);
- Të kryejë procesin e nivelimit të tokës me brana;
- Të realizojë procesin e ngjeshjes dhe nivelimin e tokës me rula;
- Të realizojë procesin e shkrifërimit të tokës me kultivatorë;

Ujitja dhe kullimi i tokës

- Të kryejë e ujitjen e tokës me mënyrën sipërfaqësore;
- Të kryejë ujitjen e tokës me brazda;
- Të realizojë ujitjen e tokës me përmbytje;
- Të kryejë ujitjen e tokës me rrëshqitje;
- Të kryejë ujitjen e tokës me shi hedhje sipas llojit të kulturës;
- Të realizojë ujitjen e tokës me pika sipas llojit të kulturës;
- Të kryejë hapjen e vijave kulluese (K3K);
- Të kryejë hapjen e brazdave kulluese (K2K);
- Të kryejë hapjen e kanaleve kulluese dhe kolektorëve (K1K);

Bimët e arave

- Të seleksionojë kultivarët e ndryshëm të të lashtave (grurë, thekër, tërshërë);
- Të seleksionojë kultivarët e ndryshëm të të vonave;
- Të kultivojë të lashtat (grurë, thekër, tërshërë, elb, etj.);
- Të kultivojë të vonat (misër) në varësi të zonës klimatiko – tokësore bazuar në agroteknologjinë përkatëse për secilën kulturë;
- Të kultivojë kulturat bishtajore për kokërr, në varësi të zonave klimatiko – tokësore, bazuar në agroteknologjinë përkatëse për secilën kulturë;
- Të përzgjedhë bimë industriale në varësi të zonës së kultivimit;
- Të kultivojë kulturat industriale më të përhapura në zonë sipas agroteknologjisë të secilës kulturë;

- Të kultivojë luledielli sipas teknologjisë bashkëkohore;
- Të kultivojë panxharë sheqeri sipas teknologjisë bashkëkohore;
- Të kultivojë bimë aromatike (nenexhik, borzilok, rozmarinë) sipas agroteknologjisë;
- Të kultivojë bimë mjekësore (sherbelë, kamomil, trumzë) sipas agroteknologjisë;
- Të kultivojë kulturën e patates në varësi të zonës klimatiko – tokësore, duke zbatuar teknologjinë përkatëse të zonës;
- Të kultivojë kulturën e duhanit në varësi të zonës klimatiko – tokësore, duke zbatuar teknologjinë përkatëse të zonës;
- Të kultivojë, për nevojat e fermës blegtorale dhe për nevoja private, kulturat foragjere, gramore, bishtajore, kryqore etj. sipas kategorive të kafshëve që disponojnë dhe qëllimit të prodhimit blegtoral;
- Të zbatojë një sistem bashkëshoqërimi dhe bashkërendimi me kultura foragjere që kultivohen në zonë, për të realizuar konvejerin e furnizimit të vazhdueshëm me bazë ushqimore të blegtorisë;
- Të përzgjedhë kulturat perimore në varësi të zonës ku shtrihet ferma bujqësore;
- Të kultivojë perime gjethore si: sallate, spinaq etj.;
- Të kultivojë perime frutrënjore (karota, rrepa, panxhari i kuq);
- Të kultivojë perime kërcellore (asparagu, preshi, hudhra);
- Të kultivojë bimë perimore që konsumohet lulja (lulëlakër, brokul);
- Të kultivojë bimë perimore për fruta si (kastravec, bamje, bizele, patëllxhan, domatja pjepri, shalqinj, speci);

Mbrojtja e bimëve

- Të organizojë këndin e prognozë- sinjalizimit për kulturat e arave që ka zona;
- Të zbatojë planin tërësor të shëndetësimin të bimëve të kultivuara;
- Të përdorë metodat që nuk dëmtojnë cilësinë e tokës dhe bimës (agroteknike, biologjike si dhe atë të integruar);
- Të kontrollojë faktorët klimatik të zonës si temperatura, lagështira, era etj.;
- Të përcaktojë saktë sëmundjen ose dëmtuesin në bazë të shenjave;
- Të përdorë tretësirë sipas përqendrimit të caktuar;
- Të kryejë trajtimin kimikate të bimëve për luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve, nën vëzhgimin e rreptë të instruktorit;
- Të vendosë tabelat lajmëruese për rrezik nga helmi;
- Të pastrojë mjetet e punës;
- Të kontrollojë cilësinë e trajtimit kimikë të bimëve;
- Të mbajë shënim rezultatet e vrojtimit të trajtimit kimik të bimëve; .
- Të analizojë rezultatet e vrojtimit;

Përpunimi i bimëve të arave

- Të përpunojë drithërat për bukë (grurë, thekër, misër etj.);
- Të pastrojë drithërat për përpunim, sipas metodave të paracaktuara;

- Të përpunojë drithërat për miell sipas procedurës;
- Të përpunojë perimet për salcë, turshi etj.;
- Të përgatisë salcë domateje;
- Të ambalazhojë salcën në kavanoz qelqi;
- Të përgatisë turshi (kastravecë , domate, lakër);
- Të përpunojë foragjeret për ushqim për blegtorinë (bar i thatë, silazh, senazh, etj.);
- Të përgatisë me mënyra të ndryshme barin e thatë;
- Të përgatisë me mënyra të ndryshme silazhin;
- Të përgatisë me mënyra të ndryshme senazhin;
- Të përgatisë komposto me fruta të ndryshme (kumbull, qershi, pjeshkë etj.);
- Të përgatisë reçel me fruta të ndryshme (kumbull, qershi, etj.)
- Të përgatisë lëngje me fruta (mollë, dardhë, portokall, rrush, kumbull, qershi etj.);
- Të përpunojë rrushin për raki, verë dhe shampanjë;

Prodhimi i farës

- Të kryejë analizat e thjeshta biometrike në laborator, për vlerësimin e prodhimit të materialit bimor në drithërat (grurë dhe misër);
- Të realizojë kontrollin dhe vlerësimin e prodhimit të farës në fushë me metodat e rekomanduara;
- Të kryejë analizat e cilësisë së farës të destinuar për mbjellje (pastërti mekanike, biologjike, fuqi dhe energji mbirëse, etj.);
- Të kryejë llogaritje të thjeshta për të gjitha punimet e kryera;
- Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat e punës;
- Të marrë masa të rrepta për sigurimin teknik në punë;
- Të vlerësojë kulturat bujqësore për prodhimtari, qëndrueshmëri ndaj të ftohtit, thatësisë, rrëzimit, si dhe sëmundjeve e dëmtuesve, duke përdorur sistemin e ballëve;

BLEGTORIA

Të ushqyerit dhe mbarështimi i gjedhit

- Të trajtojë lopët në periudhën e laktacionit;
- Të përzgjedhë mjetet e nevojshme për ushqyerjen e lopëve;
- Të përzgjedhë ushqimet për lopët në laktacion;
- Të kujdeset për viçat gjatë periudhës së mëmëzimit;
- Të ushqejë viçat sipas grup moshave;
- Të kujdeset për viçat sipas grup moshave;
- Të hartojë dhe përgatitë racionin ushqimor, sipas fazave të laktacionit;
- Të ushqejë kafshët barrsë në periudha të ndryshme të mbarështimit me racione të caktuara ushqimore;

Të ushqyerit dhe mbarështimi i të imtave

- Të trajtojë delet e dhitë gjatë periudhës së laktacionit;

- Të kujdeset për qengjat dhe kecat për pirjen e kulloshtrës në sasinë dhe kohën e duhur;
- Të kontrollojë periudhën e qumështit (mëmëzimit) në qengja e keca;
- Të kontrollojë peshën trupore të qengjave e kecape dhe kohën e shkëputjes nga nëna;
- Të përgatisë racionin ushqimor për dhentë e dhinë në laktacion sipas prodhimit të qumështit;
- Të kryejë pastrimin, larjen, masazhin e gjirit në dele e dhi;
- Të kryejë mjeljen në dele e dhi sipas vakteve;
- Të regjistrojë sasinë ditore në litër të qumështit të mjelë në dele e dhi;
- Të përzgjedhë llojin e ushqimit sipas nevojës së kafshës në regjimin stallor si: hasëlle, bar i thatë, gjethe dushku, silazh, koncentrat, etj.;
- Të përcaktojë territorin e duhur për kullotjen e deleve ose dhive;

Riprodhimi i kafshëve të fermës

- Të përzgjedhë kafshët që do të çiftëzohen në tufë (lopë, dele, dosa etj.);
- Të dallojë shenjatat e afshit në kafshë;
- Të kujdeset për tufën gjatë procesit të çiftëzimit;
- Të përcaktojë moshën dhe peshën për kafshët që do të futen në ndërzim për herë të parë;
- Të përzgjedhë metodën për inseminimin/ndërzimin e kafshëve në tufë në dele, lopë etj.;
- Të zbatojë masat veterinarë dhe higjienike në kafshët barrsë;
- Të kryejë lëvizjen e kafshëve në stalla të veçanta sipas gjendjes fiziologjike;

Trajtimi i kafshëve gjatë periudhës së tharje-pjellje

- Të kryejë procesin e tharjes në lopë;
- Të ushqejë lopët në tharje me racione me përmbajtje të ulët energjetike dhe proteinike (bar i thatë, lolium/livadhi, kashtë gruri, pak koncentrat);
- Të pakësojë sasinë e ujit që i jepet lopëve në tharje, gjatë ditës;
- Të eliminojë një vakt mjeljeje në lopë gjatë procesit të tharjes;
- Të kontrollojë gjendjen e kafshëve në muajin e fundit të mbarsmërisë;
- Të përgatisë ambientin për mbajtjen e kafshëve barrsë në periudhën e fundit të mbarsmërisë;
- Të përcaktojë kohëzgjatjen e mbarsmërisë në kafshët e ndryshme të tufës;
- Të përcaktojë nëpërmjet regjistrave datën e pjelljes së kafshës;
- Të dallojë shenjatat e afrimit të pjelljes;
- Të kontrollojë gjendjen e gjirit në muajin e fundit të mbarsmërisë në kafshë;
- Të kujdeset për tufën gjatë pjelljes dhe për të porsalindurit;
- Të dallojë një lindje normale dhe jo normale;
- Të peshojë kafshët e porsalindura;
- Të trajtojë nënën pas procesit të pjelljes nga ana higjienike dhe ushqimore;
- Të trajtojë të porsalindurit nga ana higjienike dhe ushqimore;
- Të realizojë dhënien e kulloshtrës së parë, në sasinë dhe cilësi të duhur;
- Të kryejë trajtimin e të porsalindurve në mjedis të veçanta si bokse, në profilaktor, në stalla etj.;
- Të regjistrojë operacionet e punës që do të kryhen në fermën e kafshëve bujqësore;

Trajtimi dhe mirëqenia e kafshëve të fermës

- Të zbatojë kërkesat minimale të mbrojtjes dhe mirëqenies së kafshëve për mbarështimin, prodhimin, përdorimin, shitjen, therjen, eliminimin dhe transportin, sipas llojeve të ndryshme të kafshëve;
- Të kujdeset për kafshët e fermës, gjatë transportit, në treg dhe në therje;
- Të kontrollojë gjendjen e përgjithshme shëndetësore të kafshëve të fermës, pajisjet, vendndodhjen apo ambientin ku ato rrinë, minimalisht dy herë në ditë;
- Të dallojë ndryshimet në shëndetin e kafshëve të fermës (ndryshimi i qimes, lëkura, sjellja etj.), si dhe qëndrimin e tyre në hapësira jo të pamjaftueshme gjatë të ushqyerit, pushimit, transportit, mjeljes etj.;
- Të zbatojë masat profilaktike veterinarë, sipas një plani masash veterinarë të miratuara;
- Të vendosë kafshët e importuara në karantinë për të kryer ekzaminimet e nevojshme veterinarë;
- Të izolojë kafshët e prekura ose të dyshuara, si të prekura nga një sëmundje infektive, e përcaktuar në listën përkatëse, sipas udhëzimeve të specialistit veterinar;
- Të kryejë procesin e heqjes së brirëve të kafshët e reja (viça, qengja, keca) në ditët e para pas lindjes, sipas udhëzimeve të specialistit veterinar;
- Të kryejë heqjen e brirëve me kauterizim (djegie me hekur të nxehtë) ose me pajisje elektronike;
- Të trajtojë plagën nga heqja e bririt, sipas udhëzimeve të specialistit veterinar;
- Të kujdeset për kafshët, duke ndaluar veprimet që mund të shkaktojnë dhimbje, vuajtje ose dëmtime të tyre;

Përgatitja e barit të thatë

- Të kontrollojë fushën ku do të kryhet kositja për pastrimin nga mbetjet e ngurta, barërat e këqija dhe bimët helmuese;
- Të pastrojë fushën nga mbetjet e ngurta, barërat e këqija dhe bimët helmuese;
- Të përgatisë veglat (drapër, kosë, moto korrëse etj.) për kositjen e kulturave foragjere (jonxhë, tërfil etj.);
- Të kryejë procesin e korrjes së kulturës së jonxhës dhe kulturave të tjera foragjere;
- Të respektojë të gjitha hallkat agroteknike që nga momenti i përcaktimit të fazës së bimës për tu korrur, lartësisë, kohës dhe deri në përfundim të procesit të kositjes;
- Të kryejë procesin e tharjes së barit të kositur sipas a) tharjes natyrale në fushë, b) tharjes me ajër të ngrohtë e të thatë c) tharja kimike me spërkatje të fushës me acid organik formik, artificial;
- Të kryejë kontrollin organoleptik të cilësisë së barit gjatë tharjes;
- Të transportojë barin e thatë të pangjeshur me krahë ose mjetet e transportit për në kavaletë ose hangar;

Shëndeti dhe profilaksia e kafshëve

- Të kryejë veprime të thjeshta zooveterinarë për ruajtjen e shëndetit të kafshëve;
- Të zbatojë masat për parandalimin e përhapjen e sëmundjes infektive;
- Të kryejë veçimin e kafshëve të sëmura, sipas porosisë së mjekut veterinar;

- Të ndryshojë kullotat për kafshët e sëmura;
- Të zbatojë planin e vaksinimit të kafshëve të shëndetshme;
- Të kryejë dezinfektimin e objekteve të kontaminuara nga kafshët e sëmura;
- Të sigurojë grapa dezinfektimi për këmbët, për kafshët dhe punonjësit;
- Të kontrollojë lëvizjen e kafshëve e shpendëve dhe nënprodukteve të tyre gjatë shfaqjes së sëmundjeve infektive, sidomos të zoonozave;
- Të kryejë asgjësimin e kafshëve të ngordhura, sipas rregullave;

Përpunimi i Qumështit

- Të përzgjedhë mjetet e nevojshme të punës për përpunimin e qumështit për konsum dhe për nënprodukte;
- Të higjienizojë mjetet dhe vendin e punës për përpunimin e qumështit për konsum dhe nënprodukte, sipas kushteve higjieno-sanitare;
- Të kontrollojë treguesit cilësorë të qumështit për konsum dhe për nënprodukte;
- Të transportojë qumështin në rezervuarin e grumbullimit (tankun ftohës), apo ndonjë vend tjetër të freskët;
- Të kryejë pastrimin fizik të qumështit në centrifuga ose pajisje të tjera filtruese të përshtatshme;
- Të kontrollojë densitetin e qumështit me laktodensimetër në temperature 20 gradë C;
- Të kryejë pasterizimin e qumështit nëpërmjet trajtimit termik;
- Të realizojë përpunimin e qumështit për konsum sipas teknologjisë së përpunimit;
- Të përpunojë qumështin për nënprodukte (kos, gjizë, gjalpë etj.) sipas teknologjisë përkatëse;
- Të formojë dhe kriposë djathin sipas teknologjisë përkatëse;
- Të ambalazhojë qumështin për ruajtje me ambalazhin e duhur;
- Të ambalazhojë produkte të lëngshme me bazë qumështi, me mbyllje hermetike, me pajisje mbyllëse që parandalojnë kontaminimin
- Të vendosë datën e prodhimit dhe datën e skadencës në ambalazh, në bazë të cilësisë së qumështit, sipas standardit;

Përpunimi i mishit

- Të përgatisë vendin e pranimit të shpendëve e kafshëve për therje;
- Të lajë kafshët dhe shpendët dhe t'i transportojë ato në vendin e therjes;
- Të therë shpendë ose kafshë duke përdorur mjetet përkatëse në vendet e paracaktuara;
- Të kryejë tualetin e shpendëve dhe të kafshëve pas therjes, sipas procedurës;
- Të kryejë ndarjen anatomike të shpendëve e të kafshëve sipas llojit;
- Të ambalazhojë mishin trup dhe të ndarë në mënyrë anatomike, të shpendëve e kafshëve të ndryshme;
- Të sistemojë mishin e therur të shpendëve e të kafshëve në repartet e përpunimit termik të ngrirjes;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të higjienës personale;

- Të vendosë kapuçë, maskë në hundë dhe të mbathë këpucë, në lokalet e përpunimit të qumështit dhe mishit;
- Të pastrojë dhe dezinfektojë pajisjet dhe mjetet për përpunimin e qumështit dhe mishit;
- Të respektojë procedurat e hartuara për mënyrat e ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të qumështit dhe mishit në përputhje me parimet HACCP në bazë të legjislacionit në fuqi;

Tregtimi i produkteve bujqësore e blegtorale

- Të mbledhë informacionin për konsumatorë vendas dhe të huaj;
- Të vendosë dhe ruajë marrëdhëniet me furnitorët dhe klientët;
- Të respektojë dëshirat dhe nevojat e klientit në mënyrë korrekte;
- Të komunikojë në mënyrë etike me klientin;
- Të kryejë përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të përzgjedhë pajisjet paketuuese të përdorura në përputhje me kriteret e cilësisë;
- Të zbatojë rregulloret në fuqi për paketimin e prodhimit të produkteve bujqësore e blegtorale;
- Të dallojë pasojat e paketimit të papërshtatshëm;
- Të zbatojë rregulloret për mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet e ndryshme;
- Të plotësojë një etiketë me të dhënat e duhura sipas standardit;
- Të kryejë etiketimin e produkteve të paketuara që plotëson kërkesat komerciale;
- Të ambalazhojë produktet bujqësore dhe blegtorale;
- Të magazinojë produktin sipas standardeve të kërkuara;
- Të përgatisë produktin për shpërndarje;
- Të kontrollojë cilësinë e produktit sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të përgatisë dokumentacionin shoqërues të produktit;
- Të kontribuojë në përpunimin dhe realizimin e fushatave të thjeshta të reklamave;
- Të përzgjedhë formën më të përshtatshme të reklamimit të produkteve bujqësore e blegtorale;
- Të llogarisë çmimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të plotësojë saktë një faturë shit-blerjeje duke pasur në konsideratë të gjitha elementet e faturës;
- Të përpilojë kontratat e shitjes dhe blerjes;
- Të kryejë tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në mënyrë korrekte dhe t'i dokumentojë ato;
- Të administrojë dokumentacionin e blerjeve dhe shitjeve;
- Të plotësojë të dhënat për blerjet dhe shitjet, në programin kompjuterik;

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;